



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANIE
»HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.
Nr. 01-33/02
Dt. 30.05 2012

Korporata Rajonale e Ujssjellësit "Hidroregjioni jugor" Sh.A., Rr. Wesley
Clark, pn., 20000 Prizren,

Në bazë të Nenit 138 të Ligjit Nr. 02/L-123, datë 17.05.2008, i plotësuar dhe ndërruar me Ligjin Nr. 04/L-006, të datës 23.06.2011 për Shoqëritë Tregtare, Nenit 34, të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, datë 13.06.2008, si dhe sipas Nenit 7.pika 2. e Statutit të K.R.U."Hidroregjioni jugor"Sh.A., me datë 30.05.2012, Bordi i Drejtorëve të K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A.me seli në Prizren, aprovoi këtë:

RR E G U L L O R E

MBI VESHJEN DHE PARAQITJEN ZYRTARE TË PUNONJËSVE TË K.R.U. " HIDROREGJIONI JUGOR"SH.A. NË PRIZREN

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcakton rregullat e veshjes dhe paraqitjes së punonjësve të K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A. në Prizren.

Neni 2 Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë detyruese për të gjithë punonjësit e K.R.U."Hidroregjioni Jugor"Sh.A. në Prizren.

Neni 3

Veshjet e punëtorëve, dukja personale dhe higjiena janë të rëndësishme sepse ato ndikojnë në perceptimin e të tjerëve si individ si dhe në imazhin e Korporatës, andaj nga çdo punëtorë pritet të vishet dhe të kujdeset për veten e tij/saj në pajtim me standardet e pranuar shoqërore dhe biznesore, e veçanërisht nëse puna e punëtorëve ka të bëjë me ballafaqimin me konsumatorë ose vizitorë.

Neni 4

Veshja dhe paraqitja e punonjësve duhet të jetë serioze dhe ti përgjigjet vendit dhe natyrës së punës që kryen punonjësi.

Neni 5

Punonjësit me veshjen dhe paraqitjen e tyre, gjatë kohës sa gjinden në orarin e punës, duhet të përkujdesen për paraqitjet e tyre, të cilat korrespondojnë me ruajtjen e autoritetit personal dhe të Korporatës.

Neni 6

Punonjësve të K.R.U.-së nuk u lejohen veshje të cilat:

Mbajnë një mesazh vulgariteti

Mesazh joshjeje, ose të turpshme e që si të tilla klasifikohen si jo të denja për moralin shoqërorë.

Neni 7

7.1 Rregullat e veshjes dhe të paraqitjes së punonjësve janë:

i. Këmishat dhe bluzat duhet të mbulojnë pjesën më të madhe të kraharorit;

ii. Mëngët e këmishave dhe pulovrave /bluzave, dhe veshjes në përgjithësi, nuk duhet të jenë aq të lira dhe të hapura sa të ekspozojnë trupin ose veshjet e brendshme;

iii. Veshjet e pjesës së poshtme të trupit për femra duhet të jenë në nivel të gjatësisë adekuate, nën gjunjë, të mos jenë të stër-ngushtuara ku do të ekspozoheshin në mënyrë joetike pjesët e poshtme të trupit;

iv. Nuk lejohet që të duket trupi ndërmjet veshjeve të larta dhe të poshtme;

v. Nuk lejohen pantallonat e shkurtër;

vi. Nëse mbahet rrip, ai duhet të jetë në gjatësinë dhe gjerësinë e përshtatshme, i vendosur në pjesën rreth belit në masën normale të shtrëngimit dhe jo i varur rreth belit;

vii. Mustaqet, zylyfet, llojet e ndryshme të mjekrave, lejohen vetëm nëse mbahen të pastra dhe me estetikë;

viii. Nuk lejohen kapelat, shamitë/shallet e kokës, syzet e diellit, e të ngjashme gjatë procesit të punës;

ix. Flokët duhet të mbahen mirë dhe të mos jenë të ngjyrosura me shumë ngjyra, flokët duhet të qethen në mënyrë estetike pa ekstravagancë;

x. Nuk lejohet veshja e rrobave të tejdukshme, me gjinse të përditshme, veshjet sportive, veshjet tepër të shkurta ose tepër të gjata, veshjet me rripa, dekolte tepër të thella, grim i tepërt, mbathjet sportive dhe të kohës së lirë(sandalet, papuçet, e të ngjashme), mbathjet me take tepër të larta, apo ndonjë mënyrë tjetër ekstravagante e veshjes që nuk është e përshtatshme;

xi. Veshja e të gjithë punonjësve nuk duhet të përmbajë fotografi dhe shkronja;

xii. Punonjësit duhet të kujdesën për higjienën personale dhe paraqitjen e jashtme;

xii. Punonjësit e Korporatës të cilët sipas natyrës së punës janë të detyruar që ta mbajnë uniformën zyrtare duhet që gjatë orarit të punës ta kenë të veshur uniformën detyrimisht.

Neni 8

Veshja e punonjësve meshkuj, për pozicionet drejtor dhe funksionet e tjera më të larta në hierarki se ky pozicion, duhet të jetë me kostum, këmishë, kravatë apo ekuivalente.

Veshja për punonjëset femra, për pozicionet drejtoreshë dhe funksionet të tjera më të larta në hierarki se ky pozicion duhet të jetë serioze, jo ekstravagante me funde shumë të shkurta apo këmisha e bluza dekolte.

Neni 9

Mospërfillja e dispozitave të kësaj Rregulloreje nga ana e punonjësve të K.R.U.-së përbën shkelje të Kodit të etikës dhe qeverisjes korporatave dhe ndëshkohet sipas Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të Korporatës deri me ndërprerje – shkëputje të marrëdhënies së punës.

Nëse punonjësi vishet në kundërshtim me përcaktimet sipas kësaj rregulloreje, udhëheqësi i drejtpërdrejtë në bisedë me punonjësin duhet t`ia tërheqë vërejtjen me gojë se veshja dhe paraqitja e tillë është në kundërshtim me dispozitat e rregullore së Korporatës lidhur me veshjen e punonjësve të Korporatës.

Neni 10

Në rast të mospërfilljes së vërejtjes nga paragrafi 2 i këtij neni, dhe vazhdimit të veshjes dhe paraqitjes në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i bënë vërejtje me shkrim punonjësit dhe të njëjtën e deponon në dosjen e tij/sajë personale.

Në rast se i njëjti edhe pas vërejtjes me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk sillet konform Rregullores në fjalë, atëherë mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e gëzon të drejtën e inicimit të procedurës disiplinore pranë Komisionit disiplinor të Korporatës.

Neni 11

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje janë përgjegjës mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të punonjësve të Korporatës.

Neni 12

Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Rregulloreje e bënë menaxhmenti i lartë i Korporatës së K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.

Neni 13

Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bënë Shërbimi Juridik në kuadër të Korporatës.

Neni 14

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të sajë nga ana e Kryetarit të Bordit të drejtorëve të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor"Sh.A.

Datë: 30.05.2012

Prizren,

K.R.U. "Hidroregjioni Jugor", Sh.A. në Prizren



Dr. Sci. Naser Bajraktari
Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve